



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KZAZ-VE NR. 01, NR. 09, NR. 53, NR. 66  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 00.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr. 01, nr. 09, nr. 53 , nr 66. për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 21, pika 11, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**V Ë R E N**

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- me shkresën nr. 2981 prot., datë 13.05.2019, lirim dhe emërim të tre anëtarëve të KZAZ nr.01, Qarku Shkodër.
- me shkresën nr. 2983 prot., datë 13.05.2019, lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.53, Qarku Elbasan.
- me shkresën nr. 2982 prot., datë 13.05.2019, lirim dhe emërim të dy anëtarëve të KZAZ nr.66, Qarku Berat.



- me shkresën nr. 3068 prot., datë 13.05.2019, lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.09, Qarku Kukës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesat dhe propozimet e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 11, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### **V E N D O S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ-ve sipas kërkesave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ-ve sipas kërkesave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

